# DËSHMI ARKIVI

**A-455860**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ndërhyrja e Trump dhe çmimi i shpikur, pse Gjermania kërkon shkarkimin e Infantinos |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/18/nderhyrja-e-trump-dhe-cmimi-i-shpikur-pse-gjermania-kerkon-shkarkimin-e-infantinos/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 16:28:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 18 shtator 2026, 16:21:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 18 shtator 2026, 16:20:00 UTC → 18 shtator 2026, 16:22:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a069fd291c88ea572120eba63e61b9ed5ada13913b57d9b3e3eab3ac745ec61c` |
| TEKSTI | `4a5429eb44d75e5944cfc3eacad062d082bb67b60fb686ed9477eb9157b1a7d8` |
| PAMJA | `fcf26dc3a0f7035f39ce95e99ccd998bda5402f52d6e2f93e7ccc27efbc56e79` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `694a39e96683319042f3ec067f29f84e2fe99cdb26b6cf8ee4099c9bc89f7733` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/694a39e96683319042f3ec067f29f84e2fe99cdb26b6cf8ee4099c9bc89f7733`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL KRYESORE SPORT TË FUNDIT

# Ndërhyrja e Trump dhe çmimi i shpikur, pse Gjermania kërkon shkarkimin e Infantinos

18/09/2026 18:21



**Zëvendëspresidenti i Federatës Gjermane të Futbollit, Hans-Joachim Watzke, ka kërkuar dorëheqjen e Gianni Infantinos nga posti i presidentit të FIFA-s.**

Zyrtari gjerman renditi tre arsye pse beson se Infantino nuk duhet të drejtojë më shtëpinë më të madhe të futbollit botëror. Kjo deklaratë vjen pasi Federata Gjermane refuzoi më parë të nënshkruante letrën e mbështetjes për rizgjedhjen e Infantinos. "Ai duhet të largohet, pa asnjë 'por'", deklaroi Watzke gjatë një festivali kushtuar inteligjencës artificiale në Berlin.

Si arsye të parë, ai përmendi "Çmimin e Paqes" të FIFA-s, një titull i krijuar nga vetë Infantino dhe i dorëzuar në dhjetor 2025 për presidentin e SHBA-së, Donald Trump, gjatë shortit të Kupës së Botës 2026. "Ai e shpiku vetë atë çmim dhe vendosi personalisht për t'ia dhënë atij. Nuk mund të shpikësh diçka vetë e më pas ta shpërndash sipas dëshirës. Kjo është çmenduri", u shpreh Watzke.

Rasti i dytë lidhet me sulmuesin e kombëtares së SHBA-së, Folarin Balogun, dhe vendimin polemik mbi pezullimin e tij gjatë Botërorit. Balogun u ndëshkua me karton të kuq në ndeshjen e raundit të 16-tave, por pezullimi i tij automatik prej një ndeshjeje u anulua më vonë. Sipas pretendimeve që nxitën reagime të shumta, vendimi erdhi pas një telefonate direkte mes Donald Trump dhe Infantinos.

"Nuk mund të ndodhë që kur një lojtar merr karton të kuq, kreu i shtetit të telefonojë presidentin e FIFA-s dhe çuditërisht gjithçka të ndryshojë. Është absurde", tha Watzke.

Pika e tretë e kritikave lidhet me planin e FIFA-s të paraqitur në fund të korrikut për krijimin e një kompanie tregtare të hapur ndaj investitorëve privatë. Projekti u anulua vetëm katër ditë pas prezantimit, duke nxitur pakënaqësi të mëdha në komunitetin e futbollit. "Kjo është krejtësisht çmenduri. Askush nuk dinte gjë, as zëvendëspresidentët e tij në FIFA dhe as Këshilli i FIFA-s", përfundoi Watzke.

**Top Channel**

## SPORT • KRYESORE



Eksodi te Kosova vazhdon, dy lojtarë të tjerë i japin fund aventurës me përfaqësuesen dardane pas Rrahmanit dhe Hadërgjonajt



Revolucion te Holanda, Xavi Hernandez shpall grumbullimin e tij të parë si timonier i "Tulipanëve"



Më shumë se një "Fenomen", 50 vitet e Ronaldo Nazário mes gjenisë, ligamenteve të këputur dhe jetës pa filtra



Bonucci rrëfen prapaskenat, nga refuzimi i Guardiolës, sëmundja e djalit dhe gabimi me Milanin

## ME TË LEXUARAT

E papritur në merkato/ Ylli i Kombëtares shqiptare shitet në Emiratet e Bashkuara Arabe, zbulohen detajet e kontratës

Milani nis reflektimin pas humbjes me Benficën, drejtuesit e klubit marrin vendimin për Ruben Amorim

Basketbolli në zi, ndahet nga jeta në moshën 43-vjeçare ish-ylli i NBA

Eksodi te Kosova vazhdon, dy lojtarë të tjerë i japin fund aventurës me

## Futboll »







Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top News- 'Marta Kosit nuk i takon të gjykojë vendimin'/ Avokati: Provat për Thaçin, të dobëta



Top News- Turi i Von der Leyen në Ballkan/ Presidentja e KE shmang Serbinë dhe Bosnjen




Top News-'Asnjë surprizë nga roja i Kuvendit'/ PD kundër dekretit të Begajt për pagat e gjyqtarëve



Top News–Universiteti Mesdhetar, diploma të dyfishta në programet Master me Universitetin e Tuscias



Top Channel/ "Askush nuk ju kërkon të ndaloni së fituari", Rama prezanton 'Pasqyrën e Çmimeve'



Top Channel/ Zjarr në një sipërfaqe me barishte në Durrës, shërbimi zjarrfikës në luftë me flakët



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.